



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2 lidhur me nenin 14, paragrafi 1, dhe 3, te Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019”, e konform nenit 5, paragrafi 1, pika 1.3, lidhur me nenin 6 paragrafi 3 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenit 15 lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

JEPET PËLQIMI-për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 1 (një) deri në 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës si më poshtë;

- 1.1 Banesa e cili gjendet në rrugën “Brigada 123” në Suharekë, me sipërfaqe të përgjithshme prej **58.97m²**, sipas certifikatës së pronës **O-72116046-56-2-3-0** me numër të certifikatës **Nr. 1668-2024**, të datës **14.05.2024**, zona kadastrale **Suharekë**, vendi i quajtura **“Fshat”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Komunës së Suharekës, për banim.
- 1.2 Banesa e cili gjendet në rrugën “Brigada 123” në Suharekë, me sipërfaqe të përgjithshme prej **58.97m²**, sipas certifikatës së pronës **O-72116046-56-2-7-0** me numër të certifikatës **Nr. 1668-2024**, të datës **14.05.2024**, zona kadastrale **Suharekë**, vendi i quajtura **“Fshat”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Komunës së Suharekës, për banim.
- 1.3 Banesa e cili gjendet në rrugën “Brigada 123” në Suharekë, me sipërfaqe të përgjithshme prej **58.97m²**, sipas certifikatës së pronës **O-72116046-56-2-10-0** me numër të certifikatës **Nr. 1668-2024**, të datës **14.05.2024**, zona kadastrale **Suharekë**, vendi i quajtura **“Fshat”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Komunës së Suharekës, për banim.
- 1.4 Banesa e cili gjendet në rrugën “Brigada 123” në Suharekë, me sipërfaqe të përgjithshme prej **58.97m²**, sipas certifikatës së pronës **O-72116046-56-2-13-0** me numër të certifikatës **Nr. 1668-2024**, të datës **14.05.2024**, zona kadastrale **Suharekë**, vendi i quajtura **“Fshat”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Komunës së Suharekës, për banim.

Neni 2

OBLIGOHET-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër, Drejtoria për urbanizëm dhe planifikim dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të Komunës, afatshkurtër dhe afatgjatë, që të zhvilloj procedurat e konkurrimit të hapur, konform

dispozitive të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019” dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI